

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Erdogan Haxhibeqiri, kryetar, Gyltene Sylejmani dhe Beshir Islami, anëtarë, në çështjen juridike të paditësit A. K. nga ..., të cilin me autorizim e përfaqëson avokati B. H. nga ..., kundër të paditurve: A. M., E. M., S. M. dhe Sh. K. , vajzërisë M., të gjithë nga ..., të paditurit nën 2,3, dhe 4 i përfaqëson av. A. . nga Gjakova, objekti i kontestit kthimi i huas, duke vendosur lidhur me revizionin e të paditurit A. M., të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, CA.nr.1774/2015 datë 8.11.2019, në seancën e kolegjit të mbajtur më 19.2.2020, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET si i pathemeltë revizioni i të paditurit A. M., paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, CA.nr.1774/2015 datë 8.11.2019.
- II. Aktgjykimi i goditur ndaj të paditurve tjerë mbetet i pashqyrtuar.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, CA.nr.1774/2015 datë 8.11.2019, është refuzuar si e pabazuar ankesa e të paditurve, dhe është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë, C.nr.301/14 të datës 2.3.2015, me të cilën është vendosur ;

“Miratohet në tërësi kërkesëpadia e paditësit A. K., nga gjakova, ashtu që detyrohen solidarisht të paditurit A. M., E. M., S. M. dhe Sh. K. e vajzërisë M., që të gjithë nga ..., që në emër të kthimit të borxhit në bazë të kontratës mbi huan, t’ia paguajnë paditësit shumën prej 35.000,00 € , me kamatë përkatëse ligjore të cilën i paguajnë bankat në mjetet e deponuara në bankë, me afat mbi një vit, pa destinim të caktuar e cila fillon të rrjedhë nga data 24.3.2003 e tutje gjer në pagimin definitiv, si dhe në emër të shpenzimeve procedurale shumën prej 574, 20

€, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarrimit .”

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, i padituri A. M. ka paraqitur revizion për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të dy aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët të prishen dhe lënda të kthehet për rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas vlerësimit të aktgjykimit të goditur dhe shkresave të lëndës në pajtim me nenin 215 të LPK-së, ka gjetur se:

Revizioni është i pabazuar.

Në procedurë të zhvilluar pranë gjykatës së shkallës së parë, është vërtetuar se paditësi me të paditurit kanë lidhur kontratë mbi huan me datë 26.2.2008, në bazë të kësaj kontrate të paditurit nga paditësi kishin huazuar shumën prej 35.000.00 €, me afat të kthimit me një vit. Me aneks kontratën e datës 2.12.2008, palët afatin e kthimit të huas kanë caktuar për datën 25.1.2009. Fakti se të paditurit kanë pranuar shumën prej 35.000,00 €, gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar me administrimin e provës materiale dhe atë të dëftesës të datës 26.2.2008, të nënshkruar nga palët ndërgjyqëse. Sipas sigurimit të kërkesës së paditësit, të paditurit kanë lënë në hipotekë lokalin afarist i cili gjendet në ngastrën kadastrale ... në sipërfaqe prej 21 m² dhe e cila gjendet në

Nga kjo gjendje e vërtetuar faktike, gjykata e shkallës së parë ka gjetur se të paditurit me asnjë provë materiale nuk kanë argumentuar faktin se ia kanë paguar paditësit shumën e huazuar prej 35.000,00 €, edhe pse kanë pasur obligim kontraktues dhe ligjor të kthejnë këtë shumë. Gjykata e shkallës së parë për aprovimin e kërkesëpadisë të paditësit është nisur edhe nga fakti jokontestues se të paditurit kanë pranuar se kanë nënshkruar kontratën lëndore dhe dëftesën për pranimin e shumës së parave prej 35.000,00 €.

Gjykata e shkallës së dytë, në procedurën ankimore ka gjetur se gjykata e shkallës së parë, duke vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike, drejt ka zbatuar të drejtën materiale kur ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit. Gjykata e Apelit ka gjetur se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë përmban arsye të mjaftuara për faktet vendimtare, të cilat i ka pranuar edhe gjykata ankimore dhe se aktgjykimi i shkallës së parë nuk përmban shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, për të cilat gjykata e shkallës së dytë kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, Gjykata Supreme e Kosovës ka gjetur se gjykata e shkallës së parë mbi bazën e vërtetuar drejt dhe në mënyrë të plotë të gjendjes faktike, drejt ka zbatuar dispozitat e procedurës kontestimore dhe të drejtën materiale kur ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar. Njëherit, aktgjykimi i goditur përmban arsye të mjaftuara për faktet relevante të vlefshme për gjykimin e drejtë të kësaj çështjeje juridike, të cilat i pranon edhe kjo Gjykatë.

Gjykata Supreme e Kosovës i ka vlerësuar si të pabazuara thëniet e të paditurit në revizion, se aktgjykimi i goditur është marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.2 (n), ngase siç theksohet dispozitivi i aktgjykimit është i pakuptimtë dhe ka të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet dhe se dispozitivi është në kundërshtim me arsyet, përkatësisht aktgjykimi i atakuar nuk ka arsye mbi faktet vendimtare, sipas vlerësimit të gjykatës së revizionit, aktgjykimi i goditur nuk është përfshirë me shkelje të tilla të procedurës, sepse dispozitivi i aktgjykimit është në pajtim me provat e administruara, kur gjykata ankimore ka gjetur se të paditurit nuk kanë përmbushur detyrimin e tyre nga kontrata e huas, ngase nuk ia kanë kthyer paditësit shumën prej 35.000,00 €, në afatin e caktuar me kontratë. Të paditurit me asnjë provë nuk kanë argumentuar faktin se të paditurit kanë kthyer shumën e huazuar. Me nenin 557 janë përcaktuar kushtet thelbësore për lidhjen e kontratës mbi huan dhe atë: “Me kontratën e huas obligohet huadhënësi t’ia dorëzojë në pronësi, respektivisht në disponim huamarrësit shumën e caktuar të hollash ose sasinë e caktuar të sendeve të tjera të zëvendësueshme, ndërsa huamarrësi obligohet t’i kthejë pas një kohe të caktuar të njëjtën shumë të hollash, respektivisht të njëjtën sasi sendesh të llojit dhe cilësisë së njëjtë mbi sendet e marra huamarrësi fiton të drejtën e disponimit respektivisht të drejtën e pronësisë “. Nga kontrata e lidhur në mes të ndërgjyqësve del se paditësi si huadhënës u ka dhënë të paditurve shumën e të hollave, me obligim që në afatin e caktuar t’ia kthejnë dhe se me këtë paditësi ka përmbushur detyrimin ndaj të paditurve, ndërsa të paditurit me moskthimin e shumës së huas, nuk kanë përmbushur detyrimin ndaj të paditësitt dhe janë obliguar që t’ia kthejnë huan në shumë prej 35.000,00 €.

Nuk qëndrojnë thëniet e revizionit se gjykata e shkallës së dytë nuk ka vlerësuar të gjitha thëniet e ankesës nga arseja se nga gjykata ankimore janë vlerësuar të gjitha pretendimet ankimore dhe janë dhënë arsye të mjaftueshme dhe bindëse të cilat janë të pranuar edhe nga gjykata e revizionit.

I padituri Asllan Meka pretendon se të paditurit e rendit të 2,3 dhe 4, nuk janë ftuar kurrë në seanca, ky pretendim nuk qëndron nga arsyeja se të paditurit Sh. M., S. M. dhe E. M. kanë autorizuar av. A.R. nga ...që t'i përfaqësojë me autorizim këta në këtë çështje juridike dhe se autorizimi gjendet në shkresat e lëndës.

Nga dëftesa e cila gjendet në shkresat e lëndës vërtetohet se të padituri kanë pranuar shumën e të hollave dhe se është nënshkrimi i tyre, dhe asnjëri nga të paditurit nuk ka kontestuar saktësinë e nënshkrimit të tyre, dhe thëniet e revizionit se ata nuk kanë pranuar të hollat, nuk qëndrojnë.

Të paditurit kanë pasur mundësinë ligjore të kontestojnë ligjshmërinë e kontratës mbi huan dhe një herit të kërkojnë anulimin e asaj si kontratë me fajde. Në këtë drejtim nuk kanë ndërmarrë asnjë veprim, ndërsa Prokuroria Publike Komunale në Gjakovë, me aktvendimin e saj PP.nr.52/2010 të datës 16.4.2010 ka hedhë poshtë kallëzimin penal ndaj të paditurit A. K., për shkak të dyshimit të veprës penale – kontraktimi i përfitimit jo proporcional nga neni 270 par. 1 të KPK-së, pasi që është konstatuar se në veprimet e këtu të paditësit, nuk ka elemente të veprës penale.

Nga arsyet e sipër përmendura, u vendos si nën pikën I të këtij aktgjykimi në kuptim të nenit 222 të LPK-së.

Ndërsa, aktgjykimi i goditur, që ka të bëjë me të paditurit E. M., S. M., Sh. K.vajzërisë M., nuk është shqyrtuar pasi që i njëjti nuk është goditur me revizion nga të paditurit në fjalë.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË

Rev.nr.2/2020 datë 19.2.2020

Kryetari i kolegjit,
Erdogan Haxhibeqiri